



Avokati i Popullit

November 30, 2023 · 🌐

Në institucionin e Avokatit të Popullit janë zhvilluar mbledhjet e Komisionit Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga radhët e shoqërisë civile.

Pjesëmarrësit në mbledhje ishin, z. Gentjan Sejrani Kryetar, z. Rigels Xhemollari sekretar, z. Eduart Mazi, anëtar, znj. Ada Ilia, anëtare dhe z. Arbër Ademi, anëtar.

Të pranishëm në mbledhjet, me statusin e vëzhguesit ishin gjithashtu përfaqësuesit nga misioni OPDAT në Shqipëri, EU4Justice, OSCE dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Pas shqyrtimit të kandidaturave nga shoqëria civile për KLGJ dhe KLP, Komisioni duke vlerësuar informacionet e dosjeve dhe informacionet shtesë nga vetë kandidatët Komisioni vendosi:

1. Konstatimin e plotësisë së kushteve ligjore dhe kriterëve formale për kandidatët: Altin Hazizaj, Erion Fejzulla, Juelda Lamçe, Violanda Theodhori.
2. Konstatimin e mosplotësisë së kushteve ligjore për kandidatët: Altin Shegani, Andi Muratej, Edison Hoxha, Nertila Sadedini, Diana Dervishi, Lefterije Lleshi (Luzi), Nada Dollani.
3. Të njoftohen kandidatët e mësipërm në mënyrë individuale, ndërkohë që Vendimi i arsyetuar do ju dërgohet brenda një afati të arsyeshëm.

Mbledhja e radhës në intervistat me kandidatët e kualifikuar do të njoftohet në ditët në vijim.
